



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www mash.gov.al

Tel: 00 355 4 226 307

Nr 1391 Prot.

Tiranë, më 28.02. 2008

UDHËZIM

Nr. 10, DATË 28.02.2008

PËR

**EKUIVALENTIMIN DHE REGJISTRIMIN NË MATURËN SHTETËRORE 2008
TË SHTETASVE SHQIPTARË QË KANË KRYER SHKOLLËN E MESME
JASHTË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13 të ligjit nr. 7952 datë 21.06.1995, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar" i ndryshuar, të vendimit nr. 78, datë 8.02.2006, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimeve në shkollat e larta publike" i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit, kanë të drejtë të vazhdojnë studimet e larta në Republikën e Shqipërisë sipas kriterëve të mëposhtme:
 - a) Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë shtetit dhe kanë dhënë provimet ekuivalente me Maturën Shtetërore (provime të detyruara D1 e D2 dhe provime me zgjedhje Z1 e Z2), pranohen në shkollat e larta publike, mbi bazën e pikëve që llogariten sipas notave të marra.
 - b) Shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit dhe që nuk kanë dhënë provimet ekuivalente me Maturën Shtetërore (provimet me detyrim D1 e D2 dhe provimet me zgjedhje Z1 e Z2), për t'u pranuar në shkollat e larta publike duhet të japin provimet me zgjedhje.



2. Shtetasit shqiptarë të përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi, paraqesin për ekuivalentim në Drejtorinë e Kurrikulës në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës deri më 15 prill 2008 dokumentet e mëposhtme :
- kërkesë me shkrim për të vazhduar shkollën e lartë publike;
 - diplomë përfundimtare origjinale të shoqëruar me vërtetimin original për notat e mbarimit të shkollës së mesme, si dhe kopje e këtyre dokumenteve, të përkthyer dhe të noterizuara;
 - fotokopje të noterizuara të pasaportës ose certifikatë lindjeje me fotografi;
3. Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ngrihet komisioni i posaçëm për ekuivalentimin e kërkesave të shtetasve shqiptarë që kanë kryer shkollat e mesme jashtë shtetit dhe do të japin provimet e Maturës Shtetërore 2008.
4. Komisioni i posaçëm, pasi njih vlefshmërinë e dëftesës shkollore, përcakton mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga shtetasi, nëse provimet e dhëna që figurojnë në diplomën përfundimtare janë ekuivalente me Maturën Shtetërore.
5. Për rastet kur provimet e dhëna janë ekuivalente me Maturën Shtetërore, komisioni i posaçëm ndjek hapat e mëposhtëm:
- bën përllogaritjen e notës mesatare të viteve të shkollimit;
 - përcakton notat e provimeve të detyruara (D1 dhe D2) dhe notat e provimeve me zgjedhje (Z1 e Z2);
 - njofton shtetasit për të plotësuar formularin A2 deri më 30 Qershor 2008.
6. Për rastet kur provimet e dhëna nuk janë ekuivalente me Maturën Shtetërore, komisioni i posaçëm ndjek hapat e mëposhtëm:
- bën përllogaritjen e notës mesatare të viteve të shkollimit dhe notat e provimeve të detyruara D1 dhe D2;
 - përcjell zyrtarisht rezultatet e mësipërme në Komisionin e Maturës Shtetërore pranë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore, ku shtetasi ka vendbanimin, brenda datës 30 prill 2008.
7. Komisioni i Maturës Shtetërore pranë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore:
- cakton shkollën ku shtetasi do të kryejë provimet me zgjedhje dhe do të plotësojë formularët A1 dhe A2;
 - përcjell pranë shkollave përkatëse notat që ka përcaktuar Komisioni i Posaçëm;
 - dorëzon zyrtarisht dhe në formë elektronike në Agjencinë e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve (AVA) formularët A1 të plotësuar nga shtetasit dhe përmbledhësen e të dhënave të shtetasve sipas tabelës T, brenda datës 5 Maj 2008.
8. Formularët A2 plotësohen nga shtetasit brenda datës 30 qershor 2008 dhe dorëzohen në Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendësministri, Drejtoria e Kurrikulës, Agjencia e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

GENC POLLO

MINISTËR